



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

---

Numri i lëndës: 2020:157130

Datë: 07.02.2023

Numri i dokumentit: 03946589

**P.nr.239/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj, bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe zyrtaren ligjore Mirlinda Gashi, si procembajtëse, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit V. Z., me vendbanim në Rr.”...”, Skenderaj, për shkak të veprës penale-Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.1582/2020 të datës 04.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datë 26.01.2023, në të cilin prezent ishin prokurori i shtetit H. B., i pandehuri V. Z. dhe i dëmtuari B. B. më datën 31.01.2023 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 07.02.2023, e përpiloi këtë :

**A K T G J Y K I M**

- **I pandehuri V. Z.**, nga babai Q. dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë B., i lindur datë ... në Skenderaj, ku edhe tani jeton në Rr.”...”, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar – baba i dy fëmijëve, i punësuar në subjektin afarist “M. V.” – Menagjer, i gjendjes së mesme ekonomike.

**- Ë S H T Ë F A J T O R -**

**SEPSE :** Me datë 01.08.2020, rreth orës 11:00, në fshatin ... – Komuna Skenderaj, në mënyrë serioze ka kanosur me fjalë dhe me gjeste personin tjetër se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe, me qëllim që ta frikësojë apo brengosë, në atë mënyrë që me automjetin e vet e ka penguar rrugën e të dëmtuarit B. B., i cili me familjen, me automjet, ka arritur para shtëpisë së tij, ku i pandehuri ka dalë prej automjetit

është afruar deri të automjeti i të dëmtuarit dhe ka kërkuar kthimin e borxhit që dy vite, me ç'rast e ka kapur për fyti, e kur bashkëshortja e të dëmtuarit ka dalë prej kerrit dhe ka bërtitur, ka ikur prej vendit të ngjarjes.

**- Me këtë kanë kryer veprën penale–Kanosja nga neni 181 par.2, lidhur me par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, e lidhur me nenet 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, 453 par.1, 463 par.1 dhe par.2 si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin :

### **- E G J Y K O N -**

**I.- Me dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400.00) Euro të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

**II.-** Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

**III.-** Obligohet i pandehuri që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**IV.-** Pala e dëmtuar B. B. me vendbanim në fshatin ... – Komuna Skenderaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **- A r s y e t i m -**

**- Rrjedha e çështjes –**

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 12.11.2020 ka parashtruar aktakuzën e saj PP.II.nr.1582/2020 të datës 04.11.2020, kundër të pandehurit V. Z., me vendbanim në Rr.”...”, Skenderaj, për shkak të veprës penale-Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1, të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale me datë 26.01.2023, e ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit H. B., i pandehuri V. Z. si dhe i dëmtuari B. B.

- Gjykata të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale nga neni 323 të KPP-së. I njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij procedurale ndërsa, sa i përket mbrojtësit të tij angazhuar me autorizim me shkrim datë 24.01.2023, i njëjti nuk ka prezentuar pasi që ishte i angazhuar në një rast tjetër penal si Av.Mbrojtës, ashtu që i pandehuri ka theksuar se revokon autorizimin ndaj tij dhe ka theksuar se tai e tutje dëshiron të mbrohet vet.

- Poashtu, gjykata në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.01.2023, të dëmtuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij. I njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij, ka paraqitur kërkesën pasurore juridike si dhe i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të pandehurit.

#### **- Vlerësimi i pranimit të fajësisë –**

- Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata të pandehurin e ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, pas njoftimit nga gjykata me favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë, shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tilla, i kërkojë falje palës së dëmtuar, duke shtuar se i dëmtuari para këtij rasti çdo herë ka qenë klient tek ai, duke marrë vetura me qera dhe se deri me tani asgjë nuk kanë pasur personale, përjashtimisht sqarimit të këtij rasti, ashtu lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht, për çka sinqerisht i kërkojë falje.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri V. Z., gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se, në bazë të nenit 248 par.2 të KPP-së, konsideroi se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, e njëjta është e mbështetur në thëniet e aktakuzës dhe se është dhënë pa kurrfarë detyrimi, i propozoi gjykatës që duke marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe ato rënduese nëse gjënë të aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri në këtë çështje penale juridike.

- Gjykata, po ashtu kërkojë mendimin dhe nga pala e dëmtuar i cili me këtë rast deklaroi se, e përkrahë fjalën e dhënë nga prokurori i shteti, duke i propozuar gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

- Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit dhe i dëmtuari, gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 326 par.2 e lidhur me nenin 248 par.4 lidhur em par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihej në barrë sipas kësaj aktakuze ngase, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve e më pas me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**- Fjala përfundimtare e palëve -**

- **Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare** deklaroi se, meqenëse i pandehuri në këtë fazë të procedurës penale ka pranuar fajësinë, në mënyrë të lirë dhe vullnetare, me çka ka konfirmuar dispozitivin e kësaj aktakuze, aktakuzë e cila është e mbështetur edhe në provat tjera materiale, i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe dënojë sipas ligjit, njëherë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësues dhe rënduese që dënimi të jetë në proporcion me dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

- **I dëmtuari në fjalën e tij përfundimtare** ndër të tjera deklaroi se, e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit po ashtu ka paraqitur kërkesën pasurore juridike si dhe i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të pandehurit.

- **I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare** ndër të tjera deklaroi se, lidhur me këtë çështje penale gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë në këtë seancë dhe të njëjtën ta marrë si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj tij, duke shtuar se është penduar thellësisht.

**- Gjendja faktike e vërtetuar –**

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të propozuara nga Prokuroria e shtetit siç janë : Raportet e oficerëve policor Nr.2020-BF-0226 të datës 01.08.2020, Deklarata e të dëmtuarit – B. B. Nr.2020-BF-0226 e datës 01.08.2020 dhënë në Policinë e Kosovës - Stacioni Policor në Skenderaj, Deklarata e dëshmitares – Sh. B. Nr.2020-BF-0226 e datës 01.08.2020, dhënë në Policinë e Kosovës – Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të pandehurin – V. Z. Nr.2020-BF-0226 i datës 01.08.2020 dhënë në Policinë e Kosovës - Stacioni

Policor në Skenderaj, Përmbajtjen e shkrimit lidhur me komunikimin në mes të të pandehurit dhe të dëmtuarit përmes rrjetit social viber si dhe nga vështrimi në foto dokumentacionin dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale - Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti me datë 01.08.2020, rreth orës 11:00, në fshatin ...– Komuna Skenderaj, në mënyrë serioze ka kanosur me fjalë dhe me gjeste personin tjetër se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe, me qëllim që ta frikësojë apo brengosë, në atë mënyrë që me automjetin e vet e ka penguar rrugën e të dëmtuarit B. B., i cili me familjen, me automjet, ka arritur para shtëpisë së tij, ku i pandehuri ka dalë prej automjetit është afruar deri të automjeti i të dëmtuarit dhe ka kërkuar kthimin e borxhit që dy vite, me ç'rast e ka kapur për fyti, e kur bashkëshortja e të dëmtuarit ka dalë prej kerrit dhe ka bërë titur, ka ikur prej vendit të ngjarjes, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit –**

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata mori rrethanat e tij personale se i njëjti është njeri familjar-baba i dy (2) fëmijëve, pastaj pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese për të njëjtin gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre çdo ditë janë në rritje e sipër.

- Sipas bindjes së gjykatës, **dënimi me gjobë** ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjkata ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për këtë të pandehur është i përballueshëm për kushtet ekonomike, si dhe të ardhurat që realizon nga marrëdhënia e punës si Menaxher në subjektin afarist “M. V.”.

- Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -**

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ**

**- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**P.nr.239/2020 me datë 07.02.2023.**

**Procesmbajtësja,**

**Mirlinda Gashi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

**Fatos Sejdijaj**

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.